



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 27.7.2020

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 27.7.2020, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr.103, datë 5.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Donika Prela

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Pasi u njohëm me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat bashkëlidhur tyre, përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, me shkresën me nr.*** prot., datë 20.7.2020, nga ana e Kolegjit, duke i analizuar ato në raport me secilin shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se mbeten për t'u marrë në shqyrtim e për t'u gjykuar nga ana e këtij trupi gjykues, të gjitha shkaqet e ankimit, të pasqyruara edhe në parashtrimet e seances gjyqësore parardhëse.

Komisioneri Publik, referuar shpjegimeve dhe provave të pretenduara, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 17.7.2020, vlerëson se nga ana formale aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit përmbushin kërkesat formale për t'u administruar në cilësinë e provës nga ky trup gjykues.

Komisioneri Publik, për sa përcjellë nga Kolegji, nisur dhe nga sa ka cituar subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e datës 17.7.2020, veçon si prova të reja, të paraqitura për herë të parë në këtë gjykim, aktet vijuese:

1. Kërkesë nr.*** prot., datë ***.5.2019, e shoqërisë "****" sh.p.k., drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, për pagesën e detyrimeve tatimore, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për shtetasin ***.***. (prova nr.1).
2. Shkresa nr.*** prot., datë ***.5.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe tatimpaguesit, shoqërisë "****" sh.p.k., me të cilën vihet në dijeni shoqëria për sistemimin, për periudhën tatimore ***.1.2006 - ***.12.2008 dhe ***.9.2010 - ***.12.2011, për pagën e shtetasit ***.*** me profesion ing. ndërtimi, sipas akt-sistemimit, datë ***.5.2019. Së bashku me shkresën, ju është përcjellë palëve dhe praktika e plotë, ndër të tjera dhe akti i sistemimit, sipas të cilit është përcaktuar lindja e detyrimeve të shoqërisë "****" sh.p.k. mbi

pagesën e kontributeve të sigurimeve, në shumën 914.029 lekë dhe tatimeve mbi të ardhurat personale, në shumën 331.303 lekë **(prova nr. 2)**.

3. Urdhër-pagesë ***, “*Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi*”, i datës ***.5.2019, mbi detyrimin e shoqërisë “***” sh.p.k., për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, në shumën totale 574.732 lekë, nga të cilat 331.303 lekë detyrimi principal mbi pagën 72.555 lekë gjobë dhe 170.874 interes **(prova nr. 3)**.

4. Praktika bankare e datës ***.5.2019, mbi likuidimin nga shoqëria “***” sh.p.k. e detyrimeve tatimore bazuar në urdhër-pagesën si më sipër, në shumën totale 574.732 lekë **(prova nr. 4)**.

5. Urdhër-pagesë ***, “*kontribute shoqërore*”, e datës ***.5.2019, mbi detyrimin e shoqërisë “***” sh.p.k., për pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në shumën totale 1.585.625 lekë, nga të cilat 914.029 lekë detyrim principal, 200.172 lekë gjobë dhe 471.424 lekë interes **(prova nr. 5)**.

6. Praktika bankare e datës ***.5.2019, mbi likuidimin nga shoqëria “***” sh.p.k., e detyrimeve të kontributeve shoqërore e shëndetësore, bazuar në urdhër-pagesën si më sipër, në shumën totale 1.585.625 lekë **(prova nr. 6)**.

7. Vërtetim nr.*** prot., datë ***.10.2019, i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, lëshuar për subjektin “***” sh.p.k., sipas të cilit ky subjekt deri më datë ***.10.2019, nuk ka detyrime tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, tatim i mbajtur në burim, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi **(prova nr. 7)**.

8. Ankim i z.***.***, kundër vendimit nr.***, nr. akti ***, datë ***.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, depozituar në sekretarinë e kësaj Gjykate me datë ***.4.2019, shoqëruar me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, nr.*** datë ***.4.2019, me palë paditës shtetasin ***.***, ish-punonjës i “***” sh.p.k. (së bashku me aktet shoqëruese) **(prova nr. 8)**.

9. Pasqyrën e lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit Donika Prela (***) pranë ***.*** Bank, për periudhën ***.11.2004 - ***.11.2007 **(prova nr. 9)**.

10. Pasqyrën e lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasit ***.***, pranë ***, për periudhën ***.1.2006 - ***.11.2006, kopje e gjeneruar në datën ***.6.2020 **(prova nr.10)**.

11. Pasqyrën e lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasës ***.***, nëna e shtetasit ***.***, për periudhën ***.6.2005 - ***.9.2005, pranë *** Bank, kopje e gjeneruar në datën ***.6.2020 **(prova nr. 11)**.

12. Vërtetim nr.*** prot., datë ***.6.2020, i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës, se shtetasja ***.*** është pensioniste, me datë të fillimit të pensionit ***.4.1995, me pension aktual në vlerën 11.952 lekë **(prova nr.12)**.

13. Kërkesë për verifikim të dhënash dhe lëshim dokumentacioni, drejtuar Degës Vendore të Punonjësve ***, Greqi, si dhe dokument të datës ***.3.2020, me vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, lëshuar nga Agjencia e Unifikuar e Sigurimeve Shoqërore Filiali, ***, *** Greqi, lëshuar për shtetasin ***.***, ku rezulton se në bazë të regjistrimeve jo definitive të të siguruarit, për periudhën 1/2002 e në vazhdim, nuk ka të dhëna **(prova nr.13)**.

14. Përgjigjja e datës ***.7.2020 e av.***.***.***, drejtuar shtetasit ***.***, ku deklaron se nga kontrolli i kryer në datën ***.3.2020, në sistemin EFKA me detajet e shtetasit ***.***, si i siguruar në IKA, institucion i cili ka lëshuar një certifikatë që nga data ***.1.2002 deri në ***.3.2020, nuk ka kontribute në emrin e tij. Sipas deklarimit të avokatit, IKA informon se për periudhën para vitit 2002 sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të secilit person të siguruar, të cilat ai personalisht i ka marrë nga punëdhënësi, janë të vlefshme dhe i siguruari duhet t’i provojë ato **(prova nr. 14)**.

15. Listë me komunikime me *email*, si dhe printime të *email*-eve të dërguara dhe të marra për objektin “*Godinë banimi dhe shërbimi 1 dhe 10 kate, me një kat banimi nën tokë*” me adresë L. nr.***, ***, Durrës, viti 2012 dhe 2013 (gjithsej 18) **(prova nr.15)**.

16. Deklaratë noteriale nr.*** rep./nr.*** kol., datë ***.7.2020, e shtetasës ***.***, në të cilën kjo shtetase, ndër të tjera, deklaron se si punonjëse pranë subjektit “***” sh.p.k. ka përfutur me

çmim preferencial sipas marrëveshjes së bërë midis saj dhe administratorit të shoqërisë ***.***, përveç pagës, dhe një apartament banimi **(prova nr.16)**.

17. Kopje të librezës së punës së kësaj shtetase, për të vërtetuar faktin se ka punuar pranë këtij subjekti, si dhe kopje të kontratës së energjisë elektrike dhe ujësjellësit për këtë apartament, së bashku me kontratë porosie datë ***.3.2015, lidhur mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe znj.***.*** dhe z.***.***, për blerjen e një ap. banimi në lagjen ***, ***, Durrës **(prova nr. 17)**.

18. Vërtetim i situatës së të ardhurave për shtetasin ***.*** dhe bashkëshorten e tij ***.***, datë ***.5.2019, lëshuar nga Zyra Vendore Voghera, Agjencia Tatimore Itali, Drejtoria e Provincës Pavia, për të ardhurat për vitet 2000-2015, vërtetuar me vulë apostile, nga Prefektura e Paviors me numër *** prot. dhe numër *** prot., datë ***.7.2019 **(prova nr.18)**.

19. Certifikata të gjendjes familjare të shtetasit ***.***, lëshuar nga Provinca e Paviors, datë ***.5.2009, me vulë apostile dhe të përkthyer në gjuhën shqipe **(prova nr. 19)**.

20. Shkresë e *** Bank nr.*** prot., datë ***.3.2020, drejtuar shtetasit ***.*** **(prova nr. 20)**.

21. Kërkesë të z.***.***, datë ***.6.2019, drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k., në të cilën i kërkohet të vihet në dispozicion informacion mbi pagesën e shumës 1.755.000 lekë, kryer nga z.***.***, në datë ***.4.2013, si dhe kopje e mandatit të tërheqjes së shumës 1.755.000 lekë nga arka e shoqërisë ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton tërheqjen e kësaj shume **(prova nr. 21)**.

22. Kthim përgjigje datë ***.6.2019, të shoqërisë “****” sh.p.k., drejtuar z.***.***, në të cilën shoqëria konfirmon faktin se shuma prej 1.755.000 lekë është depozituar nga z.***.*** në bankë, me kërkesë dhe për llogari të subjektit “****” sh.p.k., si dhe aktet provuese të shoqërisë që kjo shumë është pasqyruar në bilancin e vitit 2013 jo të shoqërisë “****” sh.p.k., por të subjektit “***.***”, person fizik **(prova nr. 22)**.

23. Kërkesë të z.***.***, datë ***.5.2019, drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Durrës, për vënien në dispozicion të praktikës së plotë që ka të bëjë me regjistrimin përfundimtar të objektit për subjektin shoqëria “****” sh.p.k. **(prova nr. 23)**.

24. Kthim përgjigje nr.*** prot., datë ***.5.2019, e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore Kadastrës, Durrës, e cila në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar për regjistrimin e pallatit të ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k. **(prova nr. 24)**.

25. Dosja penale nr.*** procedimi penal, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, datë ***.6.2015, për shtetasin ***.***. **(prova nr. 25)**.

26. Dosja penale nr.*** procedimi penal, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, datë ***.6.2014, për shtetasin ***.***. **(prova nr. 26)**.

27. Informacion i administruar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, shkresë nr.*** prot., datë ***.7.2020, ku pasqyrohen të dhënat për caktimin e masave të sigurisë për veprën penale të “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt” **(prova nr. 27)**.

28. Kërkesë për informacion, datë ***.7.2020, me qëllim verifikimin e fakteve të pretenduara nga kallëzuesi ***.***, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe kthim përgjigje nr.*** prot., datë ***.7.2019, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimin të Organizuar, Tiranë **(prova nr. 28)**.

29. Përgjigje e mjekut të familjes, ***.***, datë ***.7.2020, shkruar me shkrim dore, mbi një fletë rekomandimi, *rezulton se shtetasi ***.*** nuk është trajtuar me raport për paaftësi në punë nga viti 2003-2020* **(prova nr. 29)**.

30. Shkresa kthim përgjigje nr.***, datë ***.7.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në lidhje me faktin se subjekti nuk ka hetuar vepra penale që lidhen me punësimin e paligjshëm dhe ato në fushën e tatimeve për periudhën kohore 2003 dhe në vazhdim **(prova nr. 30)**.

31. Urdhër nr.***, datë ***.1.2004, “Për caktimin e prokurorëve që do të ushtrojnë funksionet në përbërje të Forcës së Posaçme” **(prova nr. 31)**.

32.Urdhër i përbashkët për organizmin dhe funksionimin e Forcës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar, nr. 273 prot., datë 28.1.2004 dhe nr. 256 prot., datë 28.1.2004, lidhur mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Rendit Publik, në të cilin, ndër të tjera, saktësohet se Forca e Posaçme ka autoritetin të hetojë cilëndo prej veprave penale të mëposhtme, të caktuara nga Prokurori i Përgjithshëm dhe/ose personi i përcaktuar prej tij, sipas gjykimit të tyre, ku ne germën “e” parashikohen veprat penale ekonomike (**prova nr. 32**).

33.Shkresë kthim përgjigje nr.*** prot., datë ***.7.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, informacion mbi hetimin nga subjekti të veprave penale të parashikuara nga neni 181 dhe 170/a të K. Penal (**prova nr. 33**).

Në referencë të përmbajtjes së këtyre akteve dhe nivelit të provueshmërisë në lidhje me shkaqet e ankimit, Komisioneri Publik parashtron si vijon:

I. Vlerësimi i pasurive

A. Për pasurinë nr.1, “Apartament banimi”, i ndodhur në Tiranë

A.1 Në analizë të shkakut të ankimit, për vlerësimin e ligjshmërisë së burimit për krijimin e pasurisë “Apartament banimi”, Tiranë, përfshirë këto nënçështje: (i) mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të realizuar kursimet e deklaruara në vitin 2006, në shumën 1.000.000 lekë; (ii) mundësia financiare e mbulimit të pagimit të pjesës së mbetur për këtë pasuri, nga të ardhurat e ligjshme të vitit 2007; (iii) mundësia e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit ***, për të dhënë hua shumën 15.000 euro; si dhe (iv) mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të shlyer këtë hua me të ardhura nga burime të ligjshme, nga subjekti rezulton se janë paraqitur aktet e sipërlistuar nga **prova nr. 1** deri në **prova nr.14, 29-33**.

1.1 Përsa i përket të ardhurave të ligjshme të familjes së subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me kursime pagesat e pasurisë dhe shlyerjen e huasë, bazuar në përmbajtjen e këtyre akteve, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Sa më sipër, pavarësisht se në kohën e paraqitjes së ankimit nga Komisioneri Publik nuk ka qenë e mundur të vërtetohet pagimi i tatimit në burim, sjell në vëmendjen tuaj se për të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti im, për periudhën 2006 - 2008 dhe shtator 2010 - dhjetor 2011, tashmë është paguar tatimi në burim nga subjekti që mbart detyrimin ligjor për kryerjen e kësaj pagese dhe këto të ardhura, rrjedhimisht, duhet të konsiderohen si të “ardhura të ligjshme” në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për aq kohë sa janë të ardhura të siguruara nga puna e ndershme dhe e ligjshme dhe për të cilat dokumentohet pagimi i tatimit në burim [...].*

1.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.7.2020, në Kolegj (provat nr.1-9), janë veprime të kryera për efekt të procesit të rivlerësimit nga ana e subjektit, pas depozitimit të ankimit nga ana e Komisionerit Publik dhe, si të tilla, duhet të merren me rezervë në këtë proces. Për sa ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit mbi ligjshmërinë e të ardhurave, mbetet fakt se ato duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

1.3 Lidhur me pretendimet e subjektit për ardhjen në dijeni të faktit të mospagimit të detyrimeve tatimore nga shoqëria “***” sh.p.k., për vitet 2006 - 2008, si dhe për periudhën ***.9.2010 - ***.12.2011, vetëm përmes vërtetimit nr.*** prot., datë ***.7.2018, të Drejtorisë së

Arshivës të Sigurimeve Shoqërore¹, në vlerësimin e Komisionerit Publik, ato nuk janë të besueshme, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provoi mungesën e dijenisë së saj dhe personit të lidhur me të, në lidhje me këtë shmangie. Marrim në konsideratë këtu dhe faktin se në aktet e vëna në dispozicion nga vetë subjekti, ka rezultuar se në kolonat përkatëse të listëpagesave të punonjësve të shoqërisë “****” sh.p.k., nënshkruar personalisht nga bashkëshorti i subjektit, specifikohet se paga është arkëtuar pjesërisht në llogari bankare (gjysma e vlerës së deklaruar si pagë neto, ku janë zbritur detyrimet tatimore për këtë vlerë) dhe pjesërisht *cash*, në arkën e shoqërisë (gjysma e mbetur e vlerës së deklaruar si pagë neto).

1.4 Komisioneri Publik fton trupin gjykues të mbajë në konsideratë se edhe vetë ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në nenin 21, germa “n” e tij, ndryshuar me ligjin nr. 9766/2007, parashikon si: [...] shpenzime të panjohura për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, shpenzimet për paga, shpërblime dhe çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar [...].

1.5 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi mungesën e dijenisë në zbatim dhe dispozitave të cituara më lart, në vlerësimin e Komisionerit Publik, gjendet i pajustificuar si një pretendim ligjor, për shkak dhe të njohurive profesionale të posaçme të subjektit të rivlerësimit.

1.6 Sa më sipër, vlerësohet se në rastin konkret, për shkak të situatës faktike dhe juridike të dokumentuar, konsiderohet si i pabazuar pretendimi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk ishin në dijeni të faktit, edhe pas tërheqjeve të pagës, pjesërisht në llogarinë bankare dhe pjesërisht në arkën e shoqërisë.

1.7 Sjellim në vëmendje të trupit gjykues se, në rastin konkret, situatat juridike të mësipërme, të paraqitura edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, në të cilat rezulton se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti i saj: (i) ka tërhequr pagën mujore pjesërisht në llogari bankare dhe pjesërisht *cash*, kundrejt nënshkrimit të tij, në arkën e shoqërisë, për vitet 2006 - 2008; (ii) ka paraqitur një kërkesëpadi në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, e cila, ndër të tjera, në vendimin e saj nr.*** nr. akti ***, datë ***.3.2019, ka arsyetuar se paditësi [...] *nuk arriti të provojë faktin e cenimit të së drejtës së tij, dhe padia është e papranueshme* [...]; (iii) ka ankimuar vendimin në Gjykatën e Apelit, Tiranë, më datë ***.4.2019, dhe vetë subjekti deklaroi se aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë, në pritje për shqyrtim, ndërkohë që: (iv) subjekti “****” sh.p.k. ka likujduar detyrimet e kontributeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (përfshirë dhe interesa e gjoba), në datën ***.5.2019; (v) marrëdhëniet specifike, të besimit të pretenduara mes personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit dhe z.***.***, si në cilësinë e administratorit të personit juridik, ashtu dhe atë të personit fizik, janë situata juridike dhe faktike, kontradikore me njëra-tjetrën, të mbivendosura, të cilat në tërësinë e tyre, në vlerësimin e Komisionerit Publik, duhet të merren me rezervë në këtë proces, pasi rezulton të jenë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij.

1.8 Komisioneri Publik, në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, se [...] *sipas legjislacionit të zbatueshëm, i takon punëdhënësit të zbresë nga paga dhe të paguajë në organet përgjegjëse tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dhe nuk është përgjegjësi e punëmarrësit mospërmbushja e këtij detyrimi*² [...], vlerëson se ky pretendim nuk ndikon në një interpretimin të ndryshëm të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nga sa është interpretuar tashmë gjyqësisht dhe ka gjetur pasqyrim në jurisprudencën

¹Referohuni më gjerësisht parashtrimeve të subjektit f.9-10, në seancën e datës 17.7.2020. Subjekti ka paraqitur dhe përgjigjen e mjekut të familjes, shkruar me shkrim dore, mbi një fletë rekomandimi, sipas së cilës shtetasi ***.*** nuk ka marrë asnjë ditë pushim gjatë viteve 2003-2020.

²Referohuni më gjerësisht parashtrimeve të subjektit, në seancën e datës 17.7.2020, f.6, 7 dhe 8.

e konsoliduar të Kolegjit, mbi ligjshmërinë e të ardhurave dhe detyrimin kushtetues të përmbushjes së detyrimeve përkatëse tatimore.

1.9 Përveç vendimeve të cituara në parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 17.7.2020³, vendime të cilat lidhen kryesisht me të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur, sjellim në vëmendje se në jurisprudencën e tij, Kolegji ka trajtuar me të njëjtin standard edhe ligjshmërinë e të ardhurave nga marrëdhëniet e qirasë apo kontratat e shitblerjes⁴ ku, pavarësisht faktit se kujt i takon detyrimi ligjor për të paguar detyrimet tatimore, ato konsiderohen si të ardhura të ligjshme për efekte të procesit të rivlerësimit, vetëm kur rezulton se janë paguar në kohë detyrimet tatimore përkatëse.

1.10 Po ashtu, Kolegji ka trajtuar tashmë në praktikën e tij edhe ato raste kur subjekti i rivlerësimit, gjatë procedurës gjyqësore të apelimit, me qëllim legjitimim e të ardhurave, ka kryer *a posteriori* pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara, duke gjetur interpretim edhe në këtë rast ekzistenca ose jo e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave⁵.

1.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, fakti se, gjatë kësaj kohe, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurores së seksionit Task-Forcë, juridiksioni i të cilit përfshinte hetimin e veprave penale të sferës ekonomike, duhet të çmohet në rivlerësimin e përgjithshëm nga ana e këtij trupi gjykues, pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Përmbajtja e akteve që vetë subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në prapësimet e saj, provon se veprat penale të parashikuara në Kreun III, seksioni VI i Kodit Penal, përfshijnë veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet.⁶

1.12 Po për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 17.7.2020, ndër të tjera, po ashtu ka pretenduar përdorimin e kursimeve të depozituara në llogarinë e saj bankare pranë ***.***.***, në shumën 248.055 lekë, gjendje në datë 31.12.2005, kursime të cilat Komisioneri Publik në ankimin e tij i ka marrë me rezervë në mungesë të të dhënave të plota të llogarisë bankare (**prova nr. 9**). Bazuar në provën në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: [...]shuma prej 248.055 lekë, e cila, referuar printimeve të bankës ***.***.***, datë ***.7.2020, ka qenë gjendje në llogarinë bankare nga paga ime më datë 31.12.2005, nuk është deklaruar si kursim i vitit 2005, për shkak se me deklarin e të ardhurave nga paga në DV është menduar se është përmbushur detyrimi për deklarim të saktë, duke qenë se kjo shumë kursim në fund të vitit i përket pagës së vitit 2005. Theksoj se në DV e vitit 2006 është deklaruar vetëm kursimi nga të ardhurat e vitit 2006, ndërkohë që kursimi prej 248.055 lekë, i vitit 2005, është tërhequr dhe mbajtur cash në banesë gjatë vitit 2006, me qëllim për t'u përdorur për likuidimin e banesës që do të porositej në vitin 2007 [...].

1.13 Komisioneri Publik, në vlerësim të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe çmuarjes së provave të reja (*dokumentacion bankar i lëvizjes së llogarisë bankare, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit*) konstaton se shuma 248.055 lekë ka qenë gjendje në llogarinë e pagës së subjektit në datën 31.12.2005.

1.14 Ndërkohë, në datën 31.12.2006, teprica e kësaj llogarie ka qenë në shumën 28.082 lekë (rezulton që tërheqjet kryesore të shumës së akumuluar në llogarinë e pagës janë kryer në periudhat gusht - tetor 2006). Bazuar në deklarinet e vetë subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e datës

³ Referohuni vendimit (JR) nr. 6/2019, prg. 21.12; vendimit (JR) nr. 19/2019, prg. 22.13; (JR) 3/2018, prg. 24; (JR) 7/2018, prg. 52; (JR) 32/2019, prg. 56; vendimit (JR) nr. 7/2019, prg. 24.

⁴ Referohuni vendimit nr. 16/2019 (JR), datë 18.7.2019; vendimit nr. 19/2019 (JR), datë 26.7.2019; vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019 etj.

⁵ Referohuni vendimit (JR) nr. 8/2019; vendimit (JR) nr.31/2019; vendimit (JR) nr.5/2020.

⁶ Urdhër i përbashkët për organizmin dhe funksionimin e Forcës së Posaçme kundër Krimin të Organizuar, nr. 273 prot., datë 28.1.2004 dhe nr. 256 prot., datë 28.1.2004, lidhur mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Rendit Publik, në të cilin ndër të tjera, parashikohet se Forca e Posaçme ka autoritetin të hetojë cilëndo prej veprave penale të mëposhtme, të caktuara nga Prokurori i Përgjithshëm dhe/ose personi i përcaktuar prej tij, sipas gjykimit të tyre, ku në gërmën "e", parashikohen *veprat penale ekonomike*.

17.7.2020, shuma 248.055 nuk është pjesë përbërëse e kursimeve të deklaruara në DV-2006 në shumën 1.000.000 lekë.

1.15 Në analizë të sa më sipër, pas rishikimit të të dhënave financiare, bazuar në aktet e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe pretendimet e parashtruara si pjesë e prapësimeve, rezulton se: (i) kursimi i deklaruar në vitin 2006 (*i përdorur më pas për blerjen e pasurisë apartament*) nuk mbulohet nga burime të ligjshme në një diferencë negative jo më prej -285.131, por prej -533.186 lekë. Gjithashtu: (ii) duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar posedimin e kursimeve në *cash* në DV-2006, në shumën 248.055 lekë, rezulton se dhe pretendimi i saj për përdorimin e kësaj shume në vitin 2007 në blerjen e pasurisë, nuk mund të konsiderohet i bazuar.

1.16 Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit specifikisht për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se provat e reja të paraqitura nga subjekti nuk pasqyrojnë ndonjë vlerë të shtuar lidhur me provueshmërinë e fakteve për të cilat është ngritur ankimi.

A.2 Në analizë të shkakut të ankimit mbi mundësinë e krijimit të të ardhurave nga burime të ligjshme të shtetasit ***, ***, për të dhënë hua shumën 15.000 euro, nga subjekti rezulton se janë paraqitur aktet e sipërlistuar nga **prova nr. 10** deri në **prova nr.14**.

2.1 Bazuar në përmbajtjen e këtyre akteve, subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se:[...] *Në këto rrethana, mbi bazën e dokumentacionit që është vënë në dispozicion nga vetë personi tjetër i lidhur, shtetasi ***, ***, provohet në mënyrë të pakundërshtueshme se shtetasi ***, ***, provon terësisht se ka patur mundësi financiare për të dhënë hua shumën 15.000 euro dhe po kështu ka arritur të vërtetojë se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt gjykimi sipas këtij shkak ankimi, ka humbur dhe se nuk mund të bëhet përsëri dhe nuk mund të merret në rrugë tjetër, pasi ky informacion gjendet në një shtet tjetër, atë grek... Sa më sipër, i kërkoj Kolegjit të vlerësojë se ndodhem në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr.84/2016, për të siguruar dokumentacion tjetër ligjor provues, përveç atij të administruar në gjykim në KPK dhe provave të reja që citova dhe që paraqes përpara KPA-së nga autoritetet greke mbi vërtetimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga shtetasi ***, ***, në shtetin grek [...].*

2.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, aktet e paraqitura nga subjekti në seancën e datës 17.7.2020, në Kolegj, nuk sjellin ndonjë risi dhe nuk pasqyrojnë ndonjë fakt/rrethanë juridike, të ndryshme nga sa është dokumentuar dhe nga sa ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, mbi mundësinë financiare të shtetasit ***, ***, për të dhënë me burime të ligjshme huan në shumën 15.000 euro.

2.3 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, në referencë dhe të provave të reja të paraqitura në seancën e datës 17.7.2020, konkretisht: (i) kërkesë për verifikim të dhënash dhe lëshim dokumentacioni, drejtuar Degës Vendore të Punonjësve ***, Greqi, si dhe vërtetim, datë ***.3.2020 nga Agjencia e Unifikuar e Sigurimeve Shoqërore Filiali, ***, ***, Greqi, lëshuar për shtetasin ***, ***, (**prova nr. 13**); dhe (ii) përgjigjes së datës ***.7.2020 e av. ***, ***, ***, drejtuar shtetasit ***, ***, ku jep informacion se në Greqi të dhënat figurojnë në sistem nga viti 2002 dhe në vazhdim (**prova nr.14**).

2.4 Komisioneri Publik vlerëson se, përkundër pretendimit të subjektit, se ka vend të zbatohet neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për pamundësinë për të siguruar dokumentacion mbi të ardhurat përpara vitit 2002, vlen të përmendet që gjatë hetimit në Komision nga vetë subjekti i rivlerësimit, janë siguruar dhe paraqitur dokumente nga *Instituti i Sigurimeve Shoqërore në shtetin grek, Buletini i identifikimit sigurues dhe të ardhurave (kontributeve), si dhe nga Sektori i të ardhurave nga dega vendore "C" e punonjësve në ***, në të cilën specifikohen ditët e punës dhe totali i*

kontributeve të paguara nga shtetasi ***.***⁷, nga data ***.12.1998 deri në *** janar të vitit 2001, periudhë kjo më e hershme se janari 2002.

2.5 Aktet e administruara në dosje të Komisionit nga përmbajtja, përsa i përket periudhës kohore që dëshmojnë, janë në kontradiktë me pretendimin e parashtruar po nga vetë subjekti i rivlerësimit, se është në pamundësi objektive për të siguruar këto akte, kjo, bazuar në një akt privat, të hartuar nga një avokat grek.

2.6 Përpos këtyre rrethanave ligjore dhe të faktit, që rezultojnë të provuara nga sa është administruar në dosje, Komisioneri Publik çmon të nënvizojë se në çdo rast, pretendimi i pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit të administruar nga institucione publike të shteteve të huaja, nuk mund të bazohet në interpretime të kryera nga subjekte private, cilado qoftë forma e tyre. Për këtë arsye, Komisioneri Publik vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

2.7 Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e pretenduar lidhur me punësimin dhe të ardhurat e z.***.***, në shtetin grek, vlerëson se jemi në kushtet e mungesës së plotësisë të kriterëve për vërtetimin e ekzistencës së një burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, sikundër urdhëron dispozita e pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

2.8 Për sa parashtruar nga subjekti i rivlerësimit, *mbi lëvizjet e llogarisë bankare të z.***.*** pranë nga ****, nga të cilat rezulton se, në datën ***.11.2006, shtetasi ***.*** ka tërhequr nga banka shumë 1.442.830 lekë (prova nr. 10), në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky pretendim mbetet i pabazuar. Përveç sa analizuar më sipër mbi detyrimin e subjektit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie bankare, rezulton se veprimi i datës ***.11.2006, në shumë 1.442.830 lekë, ka përshkrimin bankar që i korrespondon rivendosjes së shumës në depozitë me afat⁸ dhe jo tërheqjes në *cash* sikundër pretendon subjekti. Për më tepër, pretendimi i subjektit mbi këtë provë merret me rezervë, pasi pasqyra e kësaj llogarie nuk është e plotë për të provuar momentin e çeljes (krijimit të depozitës fillestare).

2.9 Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se provat e reja të paraqitura nga subjekti nuk pasqyrojnë ndonjë situatë të ndryshme nga sa është dokumentuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe mbetet e pakonfirmuar mundësia financiare e shtetasit ***.*** për të dhënë huan në shumë 15.000 euro, me të ardhura të ligjshme.

2.10 Në konkluzion të sa më sipër, për pasurinë “Apartament banimi”, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me të ardhura nga burime të ligjshme, blerjen e këtij apartamenti, përfshirë të gjitha nënçështjet e trajtuara në shkaqet e ankimit, duke rezultuar në kushtet e deklaramentit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, për një diferencë negative prej -2.810.126 lekë⁹.

A.3. Në analizë të shkakut të ankimit, pamjaftueshmëri e mbulimit me burime të ligjshme të likuiditeve/llogari bankare në shumë 4.501.427,89 lekë, me burim krijimi të deklaruar nga shitja e një apartamenti në Durrës, nga subjekti rezulton se janë paraqitur aktet e sipërlistuar nga **prova nr. 1 deri në prova nr. 8, provat 15 deri në prova nr.17 dhe prova 22.**

⁷Referohuni akteve në fashikullim e ILDKPKI-së, f.110 dhe në vijim, si dhe në fashikullin: *Akte dorëzuar dorazi nga subjekti f.321 dhe në vijim, në dosje të Komisionit.*

⁸Transaksioni ka përshkrimin: New Deposit.

⁹Thellimi i diferencës negative vjen nga mosdeklarimi në DV-2006 i shumës 248.055 lekë, pretenduar si kursime *cash*, referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 17.7.2020.

2.11 Bazuar në përmbajtjen e këtyre akteve, subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se¹⁰: [...] Në lidhje me këtë pikë të ankimit, mbi mundësinë tonë të kursimeve, qëndron arsyetimi dhe provat e parashtruara më sipër nga ana ime, ku rezultoi se detyrimin për pagim të tyre e ka patur punëdhënësi dhe se nga ana e tij është përmbushur detyrimi tatimor në vitin 2019 [...]. Lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: [...] Është përcaktuar me marrëveshje verbale mes palëve si pagesë për punën e kryer deri në momentin e largimit nga puna e bashkëshortit në vitin 2011, krahas pagës neto të përfituar... Ky nuk përbën çmim preferencial, por pagesë për punën e kryer... Po kështu dhe të ardhurat tona të përfituara nga shitja e apartamentit janë të ardhura të ligjshme, që rrjedhin nga punë e ligjshme e bashkëshortit dhe për të cilat është paguar rregullisht tatimi mbi fitimin e diferencës së çmimit të blerjes me atë të shitjes në momentin e regjistrimit në ZVRPP Durrës[...].

2.12 Komisioneri Publik, pa kaluar në përsëritje të argumentave të lartpërmendura mbi ligjshmërinë e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, vlerëson se aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 17.7.2020, për këtë shkak ankimi nuk provojnë të kundërtën e konkluzionit të arritur se për blerjen e pasurisë apartament në Durrës, shitja e së cilës ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë depozitë bankare, subjekti nuk provoi mbulimin me të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme, blerjen e apartamentit në lagjen nr.***, ***, Durrës.

2.13 Lidhur me marrëveshjen verbale mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe personit të lidhur, mbi çmimin preferencial, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ, për sa kohë nuk provohen nga aktet në dosje dhe as nga provat e reja të paraqitura nga subjekti, **provat nr. 15** deri në **provën nr.17**.

2.13 Në konkluzion të sa më sipër, për pasurinë likuiditete/llogari bankare, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me të ardhura nga burime të ligjshme, krijimin e kësaj pasurie, duke rezultuar në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016 për një diferencë negative prej -1.579.162 lekë.

A.4 Në analizë të shkakut të ankimit: “Transaksione monetare dhe marrëdhënie huaje të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit”

A.4.1 Lidhur me mosdeklarimin e një huaje prej 25.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit rezulton se janë paraqitur aktet e sipërlistuar nga **prova nr. 18** deri në **prova nr. 20**.

3. Bazuar në përmbajtjen e këtyre akteve, subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] Në lidhje me pretendimin për mosdeklarim të huas së sipërcituar, sqaroj se kjo hua nuk është deklaruar në deklaratimet periodike vjetore nga ana e bashkëshortit dhe në deklaratën Vetting 2017, për shkak se kjo shumë dhe marrëdhënia juridike që ka ekzistuar midis bashkëshortit dhe subjekteve nuk lidhet me pasurinë tonë dhe detyrimet tona personale si familje dhe, si e tillë, bashkëshorti, si person i lidhur i subjektit të rivlerësimit, nuk mbart detyrimin për deklarim për këtë lloj marrëdhënie [...].

3.1 Komisioneri Publik, edhe për këtë shkak të ankimit, çmon se nuk është provuar e kundërta nga prapësimet dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë detyrimin të deklarojnë pasuritë e luajtshme, interesat privatë, të krijuara këto sipas parashikimeve të dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

¹⁰Referohuni parashtrimeve të subjektit në seancën e datës 17.7.2020, f.30-34.

3.2 Dokumentacioni noterial dhe shkresor i administruar nga ILDKPKI, në vijim të korrespondencës me *** Bank provon se personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit ka mbajtur cilësinë e kreditorit ndaj shtetasit z.***.***, për shumën prej 25.000 euro. Kjo marrëdhënie interesi ritheksojmë se nuk është pasqyruar në asnjë nga deklaratimet vjetore të subjektit dhe as në Deklaratën “Vetting”.

3.3 Referuar akteve të administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka pasur të drejta reale mbi këtë shumë, nga korriku i vitit 2011 deri në qershor të vitit 2014. Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron dhe është i pabazuar.

3.4 Deklarata noteriale e hartuar mes personit të lidhur dhe z.***.***, ashtu sikur dhe shkresa e thjeshtë e hartuar mes tyre, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre dhe shprehjen e vullnetit të palëve, sa kohë në asnjë rast nuk ka patur pretendime të kundërta.

3.5 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e paraqitura prej saj gjatë procesit të rivlerësimit, pas evidentimit të kësaj marrëdhënie financiare të padeklaruar nga institucionet përkatëse, nuk gjejnë pasqyrim në përmbajtjen e akteve shkresore, që kanë formalizuar marrëdhënien e huamarrjes së re të personit të lidhur me shtetasin z.***.***. Sa kohë, hartimi, forma dhe përmbajtja e këtyre shkresave nuk është e cenuar, ato përbëjnë provë të plotë në kuptim të Kreut VIII, të Kodit të Procedurës Civile.

3.6 Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, akte të cilat lidhen kryesisht me mundësinë financiare të shtetasit ***.***, për të siguruar këtë shumë, duke i analizuar ato në raport me njëra-tjetrën dhe duke vlerësuar sjelljen e subjektit në raport me këtë pasuri, mbetet konkluzioni se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim ose përdorim të tij, në kuptim të nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës, për një diferencë negative financiare (- 3.510.950 lekë).

A.4.2 Lidhur me transaksion bankar/pagesë cash në shumën 1.755.000 lekë, viti 2013, kryer nga personi i lidhur, z.*.***, nga subjekti rezulton se janë paraqitur aktet e sipërlistuar, **prova nr. 15** dhe **prova nr.21** deri në **provën nr. 24**.**

4. Bazuar në përmbajtjen e këtyre akteve, subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se:[...] *Nga aktet e administruara ndryshe nga sa pretendon Komisioneri, provohet lidhja, shkaku ligjor dhe qëllimi i kryerjes së transaksionit nga bashkëshorti, pranë ZVRPP Durrës, në muajin prill të vitit 2013, periudhë në të cilën bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë, ndërkohë që marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë ishin ndërprerë prej dhjetorit të vitit 2011 [...].*

4.1 Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: [...] *...pagesa e shumës 1.775.000 lekë për regjistrimin përfundimtar të objektit për llogari të “****” sh.p.k. në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, nga të ardhurat e kompanisë *** sh.p.k., është një tregues tjetër që bashkëshorti ka vazhduar komunikimin dhe kryerjen e punëve të ndryshme për llogari të kompanisë, pikërisht për këtë objekt, për të cilin ai kishte interes të ligjshëm përfitimin e apartamentit sipas marrëveshjes verbale midis palëve [...].*

4.2 Komisioneri Publik fton trupin gjykues, që në vlerësimin e këtij shkaku ankimi, të ndalet në aktet mbi të cilat subjekti i rivlerësimit mbështet prapësimet e saj. Në korrespondencën e datës ***.6.2019 me personin e lidhur të subjektit të rivlerësimit, shoqëria “****” sh.p.k., nëpërmjet administratorit të saj, z.***.***, pranon se: [...] *shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka ruajtur asnjë dokumentacion, mandat apo dokument tjetër të tërheqjes së kësaj shume nga ana juaj pranë kompanisë “****” sh.p.k., por konfirmojmë faktin se kjo shumë ka si burim të ardhurat e kompanisë*

“***” sh.p.k. dhe se ju keni bërë depozitim të shumës në bankë për aplikimin në ZRP për regjistrimin përfundimtar të objektit [...].

4.3 Në të njëjtën shkresë, subjekti juridik, shoqëria “***” sh.p.k., pretendon se shuma prej 1.755.000 lekë, personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, i është dhënë nga një tjetër subjekt juridik, përkatësisht personi fizik “***.***”, entitet juridik i ndryshëm nga shoqëria “***” sh.p.k. Duke iu referuar përmbajtjes së shkresës së shoqërisë “***” sh.p.k. referohet se: [...] *Fakti që kjo shumë i përket investitorit, z.***.***, nga të ardhurat e krijuara nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe se është përdorur si shpenzim për regjistrimin përfundimtar të objektit, është pasqyruar në bilancin e vitit 2013 të “***.***”, person fizik me NIPT ***, si investitor në ndërtim për objektin e mësipërm [...].* Edhe për këtë veprim të pretenduar, nuk rezultojnë të jetë paraqitur asnjë mandat ose dokument tjetër për tërheqjen e pretenduar të kësaj shume pranë personit fizik në fjalë.

4.4 Komisioneri Publik vlerëson se është e qartë se veprimet juridike të kryera në rastin konkret ndërmjet shoqërisë “***” sh.p.k., personit fizik “***.***” dhe personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk janë të pasqyruara në ndonjë akt shkresor.

4.5 Veprimi juridik i vetëm që provohet në rastin konkret, pra kreditimi i vlerës prej 1.755.000 lekë, nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., rezultojnë të jetë i pavarur nga një marrëdhënie e re, e pretenduar vetëm në prapësimet e subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 17.7.2020, mes bashkëshortit të saj dhe personit fizik “***.***”.

4.6 Është e tepërt të parashtrijmë përpara këtij trupi gjyqësor se fakti i përputhjes së cilësisë së administratorit dhe aksionerit të një subjekti juridik përkatës me entitetin tjetër themelues të një personi fizik të regjistruar, nuk ka asnjë vlerë juridike në rastin konkret.

4.7 Pasqyrimi në regjistrat financiarë të një personi fizik, i një kreditimi bankar të kryer nga një subjekt i tretë, në favor të një subjekti tjetër juridik, nuk mund të merret në konsideratë si provë e burimit të të ardhurave, përkundrazi.

4.8 Edhe pas prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik i mbetet vlerësimit se nuk provohet lidhja, shkak ligjor dhe qëllimi i kryerjes së transaksionit nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pranë ZVRPP-së Durrës, në muajin prill të vitit 2013, periudhë në të cilën bashkëshorti i subjektit ka qënë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë, ndërkohë që marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë “***” sh.p.k. ishin ndërprerë prej nëntorit të vitit 2011.

4.9 Sa më sipër, duke analizuar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit me aktet e administruara në dosje dhe provat e reja, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, duke mbetur si i vetmi veprim juridik i provuar kreditimi i një vlere prej 1.755.000 lekë, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për shoqërinë “***” sh.p.k., veprim ky i padeklaruar në deklaratat vjetore dhe deklaratën “Vetting”.

5. *Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, duke i analizuar ato në raport me njëra-tjetrën dhe duke vlerësuar sjelljen e subjektit në raport me këtë pasuri, mbetet konkluzioni se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim ose përdorim të tij, në kuptim të nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës.*

6. *Komisioneri Publik, në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit përse më sipër trajtuar, duke përfunduar për kontrollin e kriterit të pasurisë, me një diferencë negative vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, të paplotë, të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin, në kuptim të pikës 1, 3 dhe 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe “b” dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.*

B. Vlerësimi i aftësive profesionale

B.1 Në analizë të shkakut të ankimit për çështje të tjera të lidhura me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale dhe denoncimet e publikut për subjektin e rivlerësimit

(i) Lidhur me të dhëna nga raporti mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, nga subjekti rezulton se janë paraqitur aktet e sipërlistuara nga **prova nr.25** deri në **prova nr. 27**.

7. Bazuar në përmbajtjen e këtyre akteve, lidhur me procedimet penale në ngarkim të shtetasve ***.*** dhe ***.***, subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Standardi i dyfishtë në këtë rast është ndjekur nga policia dhe jo nga ana ime si prokurorë, pasi për shtetasin ***.*** e ka sjellë për hetime të arrestuar, ndërsa shtetasin ***.***, në gjendje të lirë[...].*

7.1 Në vlerësim të sa më sipër parashtruar nga subjekti dhe nga provat e reja të paraqitura, Komisioneri Publik vlerëson se përgjegjësia mbi mënyrën dhe veprimet procedurale të hetimit, i përket prokurorit dhe ky i fundit, kurrsesi, nuk lidhet me referimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore, i drejtë apo i gabuar qoftë ai. Referuar nenit 148 të Kushtetutës, ligjit material dhe atij procedural penal në fuqi, prokurori është i vetmi autoritet ligjor të cilit i njihet e drejta e ushtrimit dhe e ndjekjes penale; dhe veprimtaria ndihmëse e oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore në këtë rast, nuk kushtëzon vlerësimin dhe kontrollin e prokurorit. Përkundrazi, është ky i fundit ai i cili udhëheq dhe vlerëson mbi bazën e ligjit dhe të faktit, veprimtarinë procedurale hetimore dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit në gjyq.

7.2 Nisur nga rrethanat e faktit, në të dyja rastet nuk konstatohet ndonjë element i ndryshëm diferencues që në zbatim të nenit 228 të K. Pr. Penale: “Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal” dhe nenit 244 të këtij Kodi: “Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit”, njëri i pandehur të procedohej nën masën e arrestit me burg dhe tjetri në gjendje të lirë, në kohën kur për të dyja këto raste, në analizë të akteve të procedimit penal, nga ana e subjektit të rivlerësimit është arritur në konkluzionin se të dy shtetasit e marrë si të pandehur kanë konsumuar elementet e veprës penale: “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”¹¹.

7.3 Si përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, elementet e mësipërme, të konstatuara në raportin profesional të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe në aktet e administrura për rastin në fjalë, janë elemente që duhen konsideruar nga Kolegji në rivlerësimin e subjektit, znj. Donika Prella, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

B.2 Lidhur me të dhëna nga denoncimet e ardhura pas depozitimit të ankimit

8. **Denoncimi i shtetasit** ***.*** Komisioneri Publik, ashtu sikurse parashtroi në seancën e datës 17.7.2020, përmes shkresës së Kolegjit nr.*** prot., datë ***.6.2020, është njohur me denoncimin nr.*** prot., datë ***.6.2020, që i përket shtetasit ***.***, ardhur pranë Kolegjit, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016: “Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve”.

8.1 Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 17.7.2020, deklaroi se është njohur me këtë denoncim nga vetë denoncuesi, shtetasi ***.***, i cili rezulton se disa më vonë pas depozitimit të denoncimit në Kolegj, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për këtë denoncim të tij. Komisioneri Publik, konstaton se në aktet e përcjella nga trupi gjykues me shkresën nr. *** prot., datë ***.7.2020, gjendet dhe shkresa: “Informacion”, e protokolluar me nr.***, datë ***.7.2020 pranë

¹¹ Parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Prokurorisë Tiranë, drejtuar znj. Donika Prele, Prokuroria e Rrethit Durrës, nga shtetasi ***.**, që mban datën ***.6.2020.

8.2 Subjekti i rivlerësimit, për këtë shkak ankimi, ka paraqitur në cilësinë e provës, shkresën datë ***.7.2020, “Kërkesë për Informacion”, drejtuar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) nga vetë ajo, në të cilën, me qëllim verifikimin e fakteve të pretenduara nga kallëzuesi, ndër të tjera, ka kërkuar: [...] të kryhen verifikime nëse në Regjistrin e Protokollit të Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë janë regjistruar në hyrje shkresat zyrtare të përcjella për trajtim nga Prokuroria e Përgjithshme¹²[...] (prova nr.28).

8.3 SPAK, me shkresën nr.**. prot., datë ***.7.2019¹³, në përgjigje të kërkesës së subjektit ka konstatuar se, nga verifikimi i katër shkresave të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk është gjendur e regjistruar në Regjistrat e Protokollit të shkresave hyrëse të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda, shkresa me nr.**. datë ***.10.2019. Po kështu, SPAK në përgjigje të kërkesës së subjektit, bashkëlidhur ka përcjellë një kopje të njësuar me origjinalin të urdhrin nr.**., datë ***.5.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, znj. Prele, për delegimin e firmës të zëvendësdrejtuesi dhe drejtuesit e seksioneve përkatëse.

8.4 Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 17.7.2020, ndër të tjera, pretendoi se: [...]drejtuesi i Prokurorisë i jep rrugë materialeve hyrëse, duke përcaktuar destinacionin dhe nuk administron dokumente [...].Komisioneri Publik, referuar këtyre pretendimeve, mbi pozicionimin e saj si drejtuese e Prokurorisë, në rastin konkret, vlerëson se ndryshimet e reja ligjore, përfshirë ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionin e prokurorisë në RSH”, nuk duhen interpretuar në drejtim të mungesës së përgjegjësisë, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të drejtuesit të Prokurorisë, rol të cilit ky ligj ia njuh, me anë të kompetencave udhëzuese dhe me natyrë jo detyruese, por duhen vlerësuar në raport me përcaktimet e nenit 43¹⁴, të ligjit nr. 97/2016.

8.5 Komisioneri Publik konstaton se denoncimi i paraqitur nga shtetasi ***.**. përmban elementet e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr.84/2016, përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen, gjeneralitetet e denoncuesit dhe numrin e kontaktit, dhe ashtu sikurse kemi parashtruar në seancën paraardhëse, vlerësojmë se ky denoncim mund t’i shërbejë vlerësimit tërësor në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe mbetet për t’u çmuar nga trupi gjyqësor i Kolegjit.

9. Denoncimi i një agjencie mediatike. Pranë Kolegjit është protokolluar me nr.**. prot., datë ***.7.2020, denoncimi i ***.**, agjenci mediatike online. Ky denoncim u përcoll me shkresën përkatëse pranë IKP-së, nga Kolegji, së bashku me aktet e tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 17.7.2020.

9.1 Komisioneri Publik, në shqyrtim të përmbajtjes së këtij denoncimi, vëren që denoncuesi pretendon se: [...] krijohen dyshime se subjekti Donika Prele, duke shfrytëzuar mjetet procedurale hetimore (përgjim), mund të ketë ushtruar presion ndaj administratorit të kompanisë ndërtuese, “**.”, për të përfitur një apartament me çmim shumë më të ulët sesa vlera normale e tregut [...]. Denoncuesi pretendon se informacionet e dhëna: [...] mund të shërbejnë si indicie për Kolegjin, për të kryer një hetim më të thelluar për rastin, në të cilin përfshihen së paku dy kritere të rivlerësimit, pasuria dhe integriteti [...].

¹²Subjekti, në kërkesën e saj, ka cituar 4 shkresa, konkretisht, shkresa nr.**., datë ***.3.2018; shkresa nr.**., datë ***.6.2018; shkresa nr.**., datë ***.8.2019; shkresa nr.**., datë ***.10.2019.

¹³Vlerësojmë se duhet të jetë lapsus viti 2019.

¹⁴Drejtuesi i Prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: a) koordinon veprimtarinë me Prokuroritë e tjera për çështje konkrete; b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji; c) jep urdhra të detyrueshëm për Policinë Gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve; ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merrret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake; d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj; dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

9.2 Denoncimi lidhet me pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, apartament me sipërfaqe 135.90 m², z. k.***, nr.pasurie ***, ndodhur në Rr. “***.***.***”, Tiranë. Nga aktet në dosje të Komisionit¹⁵ rezulton se kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit përmes kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr.*** rep./*** kol., datë ***.7.2018 (*pas plotësimit të Deklaratës Vetting*). Në cilësinë e palës shitëse në këtë kontratë janë shtetasit ***.***, dhënëse pëlqimi shtetasja ***.***, dhe në cilësinë e palës blerëse shtetasi ***.***. Çmimi i shitjes është në vlerën 110.000 euro.

9.3 Subjekti i rivlerësimit është njohur me këtë denoncim dhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, si dhe ka dhënë shpjegimet përkatëse. Komisioni, në vendimin nr.103/2019, f.19, të tij, lidhur me këtë pasuri ka konkluduar se:[...] *Zonja Prela bëri transparencë të plotë të procesit të shitjes së apartamentit të saj ekzistues, duke paraqitur njoftimet/publikimet për shitje në gazetën “***”, si dhe bëri të njohur të gjithë procesin e shitjes dhe marrjes së pagesës nga shitja e banesës së vjetër, apartament banimi me sipërfaqe 95.6 m², në Tiranë... Nga shpjegimet e dhëna, dokumentacioni provues ligjor dhe verifikimi i kryer, rezultoi se subjekti ka patur mundësi financiare për kryerjen e transaksionit për blerjen e shtëpisë, apartament me sipërfaqe 135.90 m², dhe se ato janë kryer në formën e rregullt ligjore [...].*

9.4 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se është krijuar nga: (i) shuma prej 80.000 euro, e përfituar nga shitja e apartamentit të vjetër, e përfituar në llogarinë bankare të z.***.***, më datë ***.7.2018; (ii) Shuma prej 30.000 euro është marrë nga llogaria bankare në emër të z.***.***, pranë *** Tiranë.

9.5 Komisioneri Publik sjell në vëmendje të trupit gjykues se një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie: (ii) shuma prej 30.000 euro, është pjesë e ankimit të paraqitur në Kolegj nga Komisioneri Publik pasi, nga aktet në dosje, rezulton se kjo shumë ka si origjinë depozitën prej 4.501.427,89 lekë, trajtuar në analizë të shkakut të ankimit: “*likuiditete/llogari bankare, me burim krijimi të deklaruar nga shitja e një apartamenti në Durrës*”¹⁶.

9.6 Lidhur me pretendimin e denoncuesit se: [...] *krijohen dyshime se subjekti mund të ketë ushtruar presion ndaj administratorit të kompanisë ndërtuese, “***”, për të përfituar një apartament me çmim shumë më të ulët [...], nga aktet në dosje të Komisionit, fashikulli ZVRPP, Tiranë mbi kronologjinë e blerjes së kësaj banese, konstatojmë se: (i) Pala shitëse “***” sh.p.k., përmes kontratës së shitblerjes nr. *** rep./nr.*** kol., datë ***.4.2018, i ka shitur palës blerëse, shtetasit ***.***, katër pasuri të paluajtshme që janë në pronësi individuale të palës shitëse, në të cilat përfshihet dhe apartamenti me sipërfaqe 135.90 m² në rrugën “***.***.***”. Kjo marrëdhënie shitblerjeje, rezulton se e ka origjinën në një kontratë porosie të lidhur mes shoqërisë dhe shtetasit ***.***. 4 vjet më parë. Në kontratën e shitblerjes rezulton se palët i janë referuar planimetrisë bashkëlidhur kontratës së porosisë me nr.*** rep./nr.*** kol., datë ***.6.2014 dhe amendimit të saj¹⁷. Vlera e shitjes së këtij apartamenti është në shumën prej 78.148 euro; (ii) Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit ***.***, me datë ***.7.2018.*

9.7 Komisioneri Publik konstaton se *prima facie*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, marrëdhënien e shitblerjes nuk e ka krijuar me subjektin tregtar që ka qenë objekti i verifikimeve në kuadrin e një procedimi penal të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, por me një subjekt të tretë privat.

¹⁵Referohuni fashikullit të ZVRPPP-së, në dosje të Komisionit.

¹⁶Subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision ka deklaruar: *se gjendja e llogarisë bankare, e cila më datë 31.12.2017 ka qenë në shumën 4.504.594,68, ka pësuar këto ndryshim: më datë ***.7.2018, nga gjendja e kësaj llogarie bankare është bërë nga shuma 3.784.500 lekë konvertimi në shumën 30.000 euro, nga ***, në emër të bashkëshortit ***.***, e cila, siç deklarova, është përdorur për blerjen e apartamentit të ri.*

¹⁷Subjekti, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ka paraqitur Kontratë sipërmarrje lidhur mes palëve në cilësinë e sipërmarrësit shoqëria “***” dhe në cilësinë e porositësit shtetasi ***.***, lidhur me nr.*** rep./*** kol., datë ***.6.2014.

C. Sjellja e subjektit gjatë procesit të hetimit

10. Në referencë të sjelljes së subjektit dhe bashkëpunimit gjatë procesit të rivlerësimit, sikurse parashikon neni 48 i ligjit nr. 84/2016 dhe vlerësimit të etikës profesionale, Komisioneri Publik, në seancën e datës 17.7.2020, i kërkoi trupit gjykues të njihet me përmbajtjen e dy kërkesave të subjektit për përjashtim gjyqtari nga gjykimi, për efekt të vlerësimit të qasjes të subjektit të rivlerësimit në një rast konflikti të mundshëm interesi.

10.1 Kolegji, në përgjigje të kërkesës së Komisionerit Publik, ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve, kërkesën nr.*** prot., datë 17.7.2020 të subjektit për përjashtimin e gjyqtarës së trupit gjykues, znj. Ina Rama, si dhe kërkesën nr.*** prot., datë 17.7.2020, të subjektit për përjashtimin e gjyqtarës, znj. Natasha Mulaj.

10.2 Komisioneri Publik, fillimisht, kërkon të nënvizojë dhe t'i sjellë në vemendje trupit gjykues se në të dyja kërkesat për përjashtim, konstatohet me vërejtje se, përkundër sa referojnë dispozitat procedurale penale dhe ato të ruajtjes së të dhënave personale, në lidhje me konfidencialitetin dhe trajtimin e akteve hetimore, subjekti i rivlerësimit u ka bashkëlidhur këtyre dy kërkesave, fashikuj hetimorë dhe ekstrakte të regjistrave, që përmbajnë të dhëna personale (regjistri i gjendjes civile), që kanë të bëjnë me subjekte të treta, shtetas këta të papërfshirë në këtë gjykim, që po zhvillohet pranë jush sot.

10.3 Komisioneri Publik vlerëson të konstatojë po ashtu se në të dyja rastet e kërkesave për përjashtim, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në referencë të nenit 74, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Penale, vetë subjekti në përmbajtjen e tyre, kërkesave, referon dijeninë e saj prej kohësh të fakteve të pretenduara prej saj, si për procedimin penal ndaj shtetasës ***.***, ashtu dhe me procedimin penal, në të cilin janë të përfshirë shtetasit ***.*** dhe ***.***, vëllezër të kryesueses së trupit gjykues.

C.1 Lidhur me përmbajtjen e kërkesës për përjashtim nr.*** prot., datë 17.7.2020, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka paraqitur si argumente se: [...] *Me marrjen dijëni të trupit gjykues, kam pritur që gjyqtarët znj.Ina Rama (anëtare) të deklarojë ekzistencën e konfliktit të interesit në rastin e gjykimit tim dhe të jepte dorëheqjen, pasi, me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, kam zhvilluar hetime në ngarkim të shtetasës ***.***.*** kushërirës së znj.Ina Rama, për veprën penale të parashikuar nga neni 187/1 i K.Penal... Kjo shtetase më ka bërë të ditur që është vajza e dajës së Ina Ramës dhe, për këtë fakt, ishte në dijëni dhe kushërira e saj, znj.Ina Rama. Shtetësja ***.*** ka pretenduar se po abuzoja me detyrën në rastin konkret, pasi për këtë fakt ishte konsultuar dhe me Ina Ramën dhe unë, si prokurore, nuk kisha të drejtë... Në këto kushte, unë, si kërkuese, po ju bëj së pari me dije këtë konflikt interesi të znj.Ina Rama dhe duke kërkuar njëkohësisht dhe përjashtimin e saj nga gjykimi [...].*

10.4 Nga analizimi i rrethanave dhe i akteve të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se:

(i) konstatohet se ankimi kundër vendimit të Komisionit nr.103/2019, është regjistruar pranë Kolegjit me nr. 21/2019, datë 24.4.2019; (ii) përbërja e trupit gjykues, në njoftimin në faqen zyrtare, ka qenë: Kryesuese - Natasha Mulaj; Relator - Ardian Hajdari; Anëtarë - Ina Rama; Luan Daci; Sokol Çomo; (iii) subjekti i rivlerësimit ka pranuar në kërkesën e paraqitur për përjashtim se ka qenë në dijëni të përbërjes së trupit gjykues, pas publikimit të tij në faqen zyrtare; (iv) neni 27, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: [...] *çdo person, i cili ka infomacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me*

short [...]; (v) subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar hetime në ngarkim të shtetases ***.*** në kuadër të procedimit penal nr.***, datë ***.6.2017, që ka regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në ngarkim të kësaj shtetase; (vi) subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për përjashtim, shprehet se në dijeni të faktit të lidhjes familjare të gjyqtares Ina Rama me personin nën hetim, pra që janë kushërinj të parë [...] *kam ardhur në dijeni gjatë hetimeve dhe kontaktit verbal që kam patur me personin nën hetim* [...]; (vii) hetimet kanë zgjatur deri kur subjekti i rivlerësimit me vendimin date 17.7.2017, ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve për kompetencë pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kavajë; (viii) Subjekti në seancën e datës 17.7.2020 ka deklaruar se: [...] *deri më sot kam pritur reagimin e znj.Rama dhe nga znj.gjyqtare nuk është bërë një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi* [...].

10.5 Komisioneri Publik konstaton se nga vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit *provohet fakti* që ajo vetë ka qenë në dijeni të rrethanave të konfliktit të pretenduar nga publikimi i trupit gjykues deri më 17.7.2020, kur është zhvilluar seanca e parë e këtij gjykimi, ku dhe paraqiti kërkesën për përjashtim.

10.6 Në rastin konkret, në vlerësim të të gjitha rrethanave të mësipërme, Komisioneri Publik vlerëson se paraqitja nga subjekti i rivlerësimit i kësaj kërkesë, në këtë fazë të procedurës gjyqësore të apelimit, duhet konsideruar një përpjekje për të vonuar seancën dhe, në përgjithësi, për të vonuar procesin e saj të rivlerësimit, sjellje e cila duhet të merret parasysh nga ky trup gjykues në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit bashkëpunimi dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit me Kolegjin, është faktor me rëndësi në vendimmarrjen gjatë procesit.

C.2 Lidhur me përmbajtjen e kërkesës për përjashtim nr.*** prot., datë 17.7.2020. Komisioneri Publik, pasi u njoh me përmbajtjen e kësaj kërkesë për përjashtim të kryesueses së trupit gjykues, gjyqtares Natasha Mulaj, konstaton se subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar si argument se: [...] *Me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, jam duke zhvilluar hetime në procedimin penal nr.***, datë ***.3.2020, regjistruar për veprën penale të "Shkatërrimit të pronës", "Prodhimit dhe shitjes së armëve dhe municioneve luftarake" dhe "Kanosjes", të parashikuar nga nenet 150,278, dhe 84 të K. Penal....Nisur nga mbiemri i njëjtë i personave *** që kam në hetim me atë të znj.Natasha Mulaj, kam verifikuar gjeneralitetet e personave subjekt hetimi dhe ato të kryetares së trupit gjykues znj. Natsha Mulaj dhe nga regjistri i gjendjes civile të shtetasve më ka rezultuar se bëhet fjalë për vëllezërit e anëtares së trupit gjykues... Në rastin konkret, fakti që unë zhvilloj hetimet penale sa më sipër, ku dyshohet të jenë përfshirë familjarët e gjyqtares Natasha Mulaj, vëllezërit e saj, bën të pashmangshëm konfliktin e interesit të saj në gjykimin tim dhe njëkohësisht vë në dyshim serioz të bazuar paanësinë e saj në gjykim [...].*

10.7 Edhe në lidhje me faktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në këtë kërkesë për përjashtim të gjyqtarit, nga analizimi i rrethanave dhe i akteve të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se:

(i) konstatohet se ankimi kundër vendimit të Komisionit nr.103/2019 është regjistruar pranë Kolegjit me nr.21/2019, datë 24.4.2019; (ii) përbërja e trupit gjykues, në njoftimin në faqen zyrtare, ka qenë: Kryesuese - Natasha Mulaj; Relator - Ardian Hajdari; Anëtarë - Ina Rama; Luan Daci; Sokol Çomo; (iii) subjekti i rivlerësimit ka pranuar në kërkesën e paraqitur për përjashtim se ka qenë në dijeni të përbërjes së trupit gjykues, pas publikimit të tij në faqen zyrtare; (iv) neni 27, pika 3 e ligjit nr.84/2016, parashikon se: [...] *çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short* [...]; (v) subjekti i rivlerësimit, me urdhrin datë 9.3.2020, ka regjistruar procedimin penal

nr.*/2020, në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pas administrimit të referimit, datë *.2.2020, të Komisarariatit Nr. 1, në Tiranë; (vi) subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për përjashtim, shprehet se në dijeni të faktit të lidhjes familjare të gjyqtares Natasha Mulaj me shtetasit *.** dhe **.*** [...] *Nisur nga mbiemri i njëjtë i personave * që kam në hetim me atë të znj. Natasha Mulaj, kam verifikuar gjeneralitetet e personave subjekt hetimi penal me ato të kryetares së trupit gjykues znj. Natasha Mulaj dhe nga regjistri i gjendjes civile të shtetasve më ka rezultuar se bëhet fjalë për vëllezërit e anëtares së trupit gjykues [...];* (vii) nga muaji mars 2020 deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për përjashtimin e gjyqtares Natasha Mulaj, subjekti i rivlerësimit pranon se vazhdon të jetë ajo, prokurorja e procedimit penal nr.*/2020, e cila po heton shtetasit *.** dhe **.***.

10.8 Komisioneri Publik, në vlerësim të përmbajtjes së kërkesës së subjektit për përjashtimin e gjyqtares Natasha Mulaj, në raport me pozicionim e subjektit të rivlerësimit si prokurore, vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e një konflikti të mundshëm të interesit, sipas përcaktimeve që i jep kësaj situatë ligjore, ligji nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar¹⁸.

10.9 Respektimi i dispozitave ligjore në lidhje me konfliktin e interesave, në harmoni me parashikimet përkatëse të K.Pr.P., gjen rregullim dhe në Urdhrin nr.141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, ku pika 4 e nenit 11 përcakton se prokurori duhet të zbatojë detyrimet e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

10.10 Neni 6 i ligjit nr.9367/2005, i ndryshuar, “Mënyra e kryerjes së detyrave publike dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit”, përcakton se: [...] **1.** Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët. **2.** Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit [...].

10.11 Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 75 të tij: “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, në pikën 4 të tij përcakton se: [...] *paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi [...].*

10.12 Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të të gjitha rrethanave, duhet të kishte konsideruar më së pari se ajo vetë, si zyrtare në ushtrim të detyrave publike, ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe se, në këtë kuptim, duhet të ishte subjekti i rivlerësimit që duhej të tregonte integritetin e duhur dhe të dorëhiqej nga hetimi i procedimit konkret, sa kohë ky procedim ishte regjistruar më vonë në kohë nga ardhja në dijeni e trupit gjykues, që pritej ta gjykonte në Kolegj.

10.13 Në rastin konkret, Komisioneri Publik nuk konstaton që subjekti nga ana e saj të jetë përpjekur të zgjidhë situatën e konfliktit të mundshëm të interesit, nisur nga fakti se, ashtu sikurse e ka pranuar në seancën e datës 17.7.2020: [...] *nuk pretendon se znj. N. Mulaj ka qenë në dijeni, pasi dhe ajo vetë e ka konstatuar këtë javë [...].*

¹⁸ Neni 3, pika 4, germa “c”, përcakton se: “konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

10.14 Edhe në rastin konkret, në vlerësim të të gjitha rrethanave të mësipërme, së bashku me sa u argumentua për cenimin e etikës, ku rezulton më së pari vetë subjekti i rivlerësimit të ketë shmangur detyrimin ligjor për të mos lejuar konfliktin e interesit, duke u dorëhequr ajo vetë nga procedimi penal në ngarkim të vëllezërve të gjyqtarës Natasha Mulaj, Komisioneri Publik vlerëson se paraqitja nga subjekti i rivlerësimit i kërkesës për përjashtim për këtë gjyqtare, në këtë fazë të procedurës gjyqësore të apelimit, duhet konsideruar një përpjekje për të vonuar seancën dhe, në përgjithësi, për të vonuar procesin e saj të rivlerësimit, sjellje e cila duhet të merret parasysh nga ky trup gjykues në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit bashkëpunimi dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit me Kolegjin, është faktor me rëndësi në vendimarrjen gjatë procesit.

10.15 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit, në të dyja rastet e paraqitjes së kërkesës për përjashtim, duhet të vlerësohet nga Kolegji në analizë të vlerësimit etiko-profesional, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 48 dhe 61/5, të ligjit nr. 84/2016.

10.16 Si përfundim, mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7, nenit D, pika 1, 3 dhe 5, nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pikat 3 dhe 5, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, duke i qëndruar të gjithave shkaqeve të ankimit të paraqitur, Komisioneri Publik i kërkon këtij trupi të shprehet mbi kërkimin përkatës të ankimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA